

Formular Tip 1.

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHEM PER TU PARAQITUR

I. TË DHËNA MBI PRODHUESIN ME PERPARESI TE ENERGJISE ELEKTRIKE

A.- Emri i plote i shoqërisë shoqërisë prodhuese te energjise elektrike.

- 1) Adresa ose selia e shoqërisë.
- 2) Numri i Telefonit dhe adresa e e-mailit

B.- Administratori i shoqërisë ose përfaqësuesi ligjor i caktuar me prokure (nëse ka).

- 1) Emër, Mbiemër
- 2) Fotokopje e kartes se identitetit ose pashaportes.
- 3) Numri i telefonit.
- 4) Adresa e e-mailit.

II. DOKUMENTA JURIDIKE

1. Kerkese me shkrim e shoqërisë prodhuese per lidhje kontrate shitblerje te energjise elektrike me shoqërine OSHEE sh.a, 30 dite perpara se impianti prodhues te vihet ne shfrytezim te plote e te filloje prodhim/livrimin e Energjise. (*Bazuar ne kontraten Tip te ndryshuar te Shit-Blerjes se energjise, te miratuar nga ERE me vendimin me Nr. 147, date 30.09.2016, NENI 4 (Dokumentacioni Paraprak, Tensioni, Frekuenca).*)
2. Shkresa e Lejes së miratuar të Lidhjes me rrjetin shperndares te OSHEE sh.a ose OST sh.a e leshuar nga operatori perkates i rrjetit. Mareveshja e Lidhjes me operatorin e rrjetit perkates.
3. Kontrata koncesionare ose kontrata privatizimit e nenshkruar me Ministrine e Energjitikes dhe Industrise.
4. Ekstrakti i thjeshte dhe ekstrakti historik ne origjinal i QKR se shoqërisë qe ka nenshkruar kontraten e koncesionit ose kontraten e privatizimit me Ministrine e Energjitikes dhe Industrise.
5. Ekstrakti i thjeshte dhe ekstrakti historik ne origjinal i QKR per shoqërine e licensuar per prodhimin dhe tregtimin e energjise elektrike.
6. Njoftimin zyrtar nga ana e shoqërisë prodhuese drejtuar Autoritetit Kontraktues (MEI) dhe AKBN per perfundimin e punimeve dhe venien ne shfrytezim te impiantit prodhues.
7. Deklarate Dakordesie per livrimin e energjise elektrike te prodhuar me tension dhe frekuencë ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

III. DOKUMENTA TEKNIKE

1. Licenca per prodhimin e energjise elektrike te leshuar nga ERE.
2. Gen-Plani i vendosjes se objektit ne shkalle1; 25.000 (ne format A3).
3. Planimetria e detajuar e HEC ku tregohet vendodhja e paisjeve dhe e sistemit mates.
4. Skema e plote principale elektrike e Centralit, Nenstacionit ngrites dhe lidhjes me sistemin elektroenergjitik (single line diagram).
5. Specifikimet teknike e te gjithë elementeve te Centralit prodhues, Nenstacionit ngrites dhe lidhjes me rrjetin si: tipi i gjeneratorit sinkron/asinkron dhe parametrat e tij, transformatorit rrites te fuqise dhe transformatorit te nevojave vetjake, çelsave, ndaresve, zbarave, te hyrjeve dhe daljeve te linjave, kabllot, izolatore, shkarkues, etj.
6. Skema principale e mbrojtjes rele. Tipet e releve, funksionet dhe tarimet e tyre.
7. Skema principale e Kontrollit & Monitorimit, telekomunikacionit dhe arkitektura e SCADA (nese ka).
8. Skema principale e Sistemit te Matjes duke pasqyruar te gjitha elemente e saj.
9. Specifikimet teknike e te gjithë elementeve te sistemit te matjes (aparati mates elektrik, transformatoreve te rrymes dhe tensionit).
10. Katalogjet dhe manuallet e perdorimit te aparatit mates, katalogjet e trasformatoreve te rrymes dhe tensionit.
11. Certifikata e kalibrimit te matesit, e leshuar nga Drejtoria e Pergjithëshme e Metrologjise/Laboratori i Matjeve Elektrike (perjashtohen matesit e prodhuar sipas MID 16 e me pas).
12. Ekstrakti i printuar i parametrizimit te matesit, ne rast se matesi eshte i parametrizuar.
13. Relacioni teknik i mbajtur per testimet e kryera per venien ne pune te HEC-it shoqeruar me protokollet e testimave te kryera, pasi te pregatiten dhe dorezohen subjektit koncensionar nga AKBN.
14. Planifikimin mujor/vjetor te prodhimit te energjise.
Pas venies ne shfrytezim te HEC, ky planifikim duhet te paraqitet cdo fillim viti per vitin ne vazhdim.

IV. KERKESA TEKNIKE QE DUHET TE PLOTESOJE SISTEMI I MATJES

1. Sistemi i matjes se energjise se prodhuar do te instalohet ne piken e levrimit, ne te cilen Sistemi i Matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE për këtë qëllim.
2. Sistemi i matjes se energjise se prodhuar nga centralet prodhuese duhet te lidhet ne dalje sekondare te vecanta te trasformatoreve te rrymes dhe tensionit, qe sherbejne vetem per ushqimin e qarqeve te matjes se energjise se prodhuar dhe nuk mund te sherbejne njekohesisht edhe per ushqimin e qarqeve te mbrojtjes apo te matjes se parametrave te tjere elektrike.
3. Qarqet sekondare te trasformatoreve te rrymes dhe tensionit nuk duhet te kene pika nderprerje deri tek aparati mates i energjise.

4. Transformoret e rrymes dhe te tensionit duhet te jene mundesi vulosje te kapakeve te morseterive te tyre dhe nese kjo nuk eshte e mundur duhet te vendosen ne nje panel vecante i cili duhet te kete mundesi vulosje.
1. Aparati mates i energjise elektrike duhet te plotesoje te gjitha standartet nderkombetare IEC si edhe MID.
2. Aparati mates i energjise elektrike duhet te jete i markuar me simbolin CE
3. Aparati mates i energjise elektrike per qellime standartizimi, duhet te jete i tipit elektronik multifunksional i afte te realizoje matje dhe monitorim te fuqise dhe energjise elektrike aktive, reaktive, ne te dy drejtimet marrje – dhenie ne kater kuadratet.
4. Aparati mates duhet te jete i paisur me aksesoret dhe antenen per komunikim, me portat e komunikimit RS 485, RS 232 dhe Ethernet, i afte te transmetoje te dhenat nepermjet modemave GSM/ GPRS/EDGE ne drejtim te qendres se menaxhimit te te dhenave prane OSHEE sha.
5. Te jete i afte te komunikojte nepemjet disa protokolleve, duke perdorur ato me te avancuarat e kohes si Modbus, DNP, UDP/IP, DLMS/COSEM etj.
6. Aparati mates i energjise elektrike, transformoret e rrymes dhe te tensionit duhet te plotesoje klasen e saktetise sipas kodit te Matjes, pika III.5.2.
7. Libri i leximit ditor te matesit te energjise, duhet te mbahet gjate gjithes kohes ne HEC. Ky liber duhet te jete me flete te numeruara dhe te vulosura.

Shenim:

Te gjithes dokumentat e kerkuara duhet te jene origjinale ose fotokopje te noterizuara.

Ne rast te mosplotesimit te listes se dokumentave te mesiperme dhe kushteve teknike te kerkuara, nuk kryhet lidhja e kontrates per shitblerjen e energjise me OSHEE sha.

Dokumentat e mesiperme duhet te dorezohen zyrtarisht ne rruge protokollare 30 dite perpara se impianti te vihet ne shfrytezim per te filluar prodhimin e energjise elektrike, siç citohet ne kontraten TIP te miratuar nga ERE.

Te dhenat e pershkruara ne pikat: III-4; III-8; III-9; III-10; III-11 dhe libri i leximit duhet te ndodhen ne cdo kohe ne ne impiantin prodhues dhe do te verifikohen gjate kontrolleve qe do te kryhen nga ana e OSHEE sha.